

## Procesverbal- Tipi i kontratës - Mallra

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**Objekti i procedurës:** “Blerje materiale sinjalistike në det për plazhet publike”.

**Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP):** 34928471-0: Materiale sinjalistike, 34928470-3: Sinjalistikë

**Vlera e fondit limit:** 2,484,200 (dymilion e katërqindetëdhjetekatërmijë e dyqind) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

##### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

##### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

##### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

*Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar. Ky kriter synon të sigurojë që çdo operator ekonomik të konfirmojë paraprakisht, nën përgjegjësi ligjore, përmbushjen e kushteve dhe kërkesave të përgjithshme të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik. Përmes vetëdeklarimit mundësohet një zhvillim më efikas i procedurës së vlerësimit të ofertave, duke shmangur ngarkesën

administrative të paraqitjes së menjëhershme të dokumentacionit të plotë nga të gjithë ofertuesit, ndërkohë që autoriteti kontraktor ruan të drejtën për të kërkuar dhe verifikuar dokumentacionin provues përkatës në fazat e mëvonshme të procedurës, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

*2.2.1 OE duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 35 % e vlerës së fondit limit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomikë dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 35 % e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...*”. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “*Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave*”.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

*2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

*a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore*

*të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën” nenit 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se “Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit.

Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar.

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

*2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar, (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) për tregtimin e mallrave objekt-prokurimi.*

**Argumentimi:** Ky kriter gjen mbështetje në pikat 2 dhe 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 5 të nenit 44 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku është e cituar: 5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që

subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues (ref. Vendimit të KPP nr. 353/2014).

Këto pajisje janë pjesë përbërëse e sistemit të sinjalistikës detare dhe përdoren në kushte të drejtpërdrejta detare, ku kërkohet qëndrueshmëri e lartë ndaj korrozionit, rrezatimit UV, dallgëve dhe konsumimit mekanik.

Siguria dhe funksionaliteti i bovave sinjalizuese varen drejtpërdrejt nga cilësia e materialeve, stabiliteti në ujë, dukshmëria sipas standardeve të ngjyrave dhe dimensioneve, si dhe nga rezistenca e aksesorëve lidhës si spirancat dhe litarët.

Nëse këto produkte nuk janë të certifikuara ose nuk prodhohen sipas standardeve të kërkuara, ekziston rreziku i dëmtimit të shpejtë, humbjes së funksionit sinjalizues dhe si pasojë rrezikimit të sigurisë në lundrim.

Në këtë kontekst, autorizimi nga prodhuesi ose distributori i autorizuar shërben si garanci që operatori ekonomik furnizon produkte origjinale dhe të testuara, që plotësojnë specifikimet teknike dhe standardet përkatëse. Ky autorizim siguron një zinxhir të besueshëm furnizimi dhe mundëson mbështetje teknike, zëvendësim apo garanci në rast defektesh, duke rritur kështu besueshmërinë e furnizimit dhe jetëgjatësinë e pajisjeve të prokuruar.

*2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatat përkatëse CE ose deklaratë konformiteti (kur është e aplikueshme) për të gjithë artikujt.*

**Argumentimi:** Ky kriter është bazuar në pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

Ky kriter është bazuar në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Ky kriter kualifikimi është në përputhje me kërkesat për sigurinë dhe cilësinë e produkteve që do të prokurohen, të cilat janë pjesë e sinjalistikës detare dhe përdoren në kushte të ndjeshme operationale. Artikujt si bovat lundruese sinjalizuese, spirancat dhe litarët lundruar duhet të jenë të prodhuar sipas standardeve të përcaktuara dhe të garantohen për performancë të qëndrueshme në mjedis detar, ku ndikojnë faktorë si korrozioni, ekspozimi ndaj rrezeve UV dhe ngarkesat mekanike.

Kërkesa për paraqitjen e certifikatës CE ose deklaratës së konformitetit (kur është e aplikueshme) siguron që produktet përmbushin kërkesat thelbësore të direktivave dhe rregulloreve përkatëse evropiane në lidhje me sigurinë, shëndetin dhe mbrojtjen e mjedisit. Kjo është veçanërisht e

rëndësishme për produkte që ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë e lundrimit, pasi garanton që ato janë testuar dhe verifikuar sipas procedurave të njohura.

Nëpërmjet këtij kriteri, autoriteti kontraktor sigurohet që mallrat e ofruara janë të certifikuara, të besueshme dhe në përputhje me standardet teknike të kërkuara, duke minimizuar rrezikun e furnizimit me produkte jo cilësore ose të pasigurta. Gjithashtu, ky dokumentacion përgjegjshmërinë e operatorëve ekonomikë, si dhe lehtëson verifikimin teknik gjatë fazës së vlerësimit të ofertave dhe gjatë zbatimit të kontratës.

*2.3.4 Për të gjithë artikujt, duhet të paraqiten katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet për të cilat oferton, sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.*

**Argumentimi:** Ky kriter është bazuar në nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, si dhe pikën 6/b të nenit 40 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, në të cilën është përcaktuar se: [...] 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: [...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].

Paraqitja e katalogjeve për të gjithë artikujt që janë objekt prokurimi është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së mallrave që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Ky kriter kualifikimi lidhet drejtpërdrejt me nevojën për verifikim të saktë dhe të detajuar të produkteve që ofrohen në kuadër të sinjalistikës detare. Artikujt si bovat lundruese sinjalizuese, spirancat dhe litarët lundrues kanë karakteristika specifike teknike që ndikojnë drejtpërdrejt në performancën, qëndrueshmërinë dhe sigurinë e tyre në përdorim, ndaj është thelbësore që këto parametra të dokumentohen qartë dhe të jenë të verifikueshëm.

Paraqitja e katalogjeve me specifikime të hollësishme teknike mundëson që autoriteti kontraktor të krahasojë në mënyrë objektive ofertat dhe të vlerësojë përputhshmërinë e produkteve me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Përfshirja e pjesëve të katalogut ku evidentohen qartë emërtimi dhe karakteristikat teknike të artikujve shmang paqartësitë dhe interpretimet e gabuara gjatë procesit të vlerësimit.

Detyrimi për të markuar në katalog produktet konkrete që ofertohen sipas numrit rendor rrit transparencën dhe lehtëson identifikimin e tyre, duke siguruar që nuk ka konfuzion midis produkteve të ndryshme apo varianteve të tyre. Ndërkohë, dorëzimi i katalogjeve në formë elektronike nëpërmjet sistemit të prokurimit garanton standardizim të dokumentacionit, akses të lehtë dhe gjurmueshmëri gjatë gjithë procesit të vlerësimit.

Në këtë mënyrë, kriteri kontribuon në një vlerësim teknik të saktë, të drejtë dhe të bazuar në prova konkrete, duke siguruar që produktet e përzgjedhura përmbushin kërkesat funksionale dhe teknike për përdorim në kushte detare.

2.3.5 *Operatori ekonomik, në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë mostër për artikujt nr. 1, 2, 4 dhe 6. Mostrat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën “Specifikimet Teknike” të DST-së. Paraqitja e mostrave jo në kohën e përcaktuar si dhe jo sipas specifikimeve teknike, përbën kusht skualifikimi.*

**Argumentimi:** Kërkesa për paraqitjen e mostrave është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”*

Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike dhe funksionale të përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit. Kjo përfshin verifikimin e cilësisë së produktit sipas specifikimeve teknike. Mostra do t’i kthehet ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostra i kthehet ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

Ky kriter kualifikimi është teknikisht i domosdoshëm për sigurinë dhe verifikimin e cilësisë së produkteve që do të prokurohen. Artikujt për të cilët kërkohen mostrat – si spiranca për lidhjen e bovave detare, bovat lundruese sinjalizuese bikonike dhe cilindrike, dhe transportuesit e materialeve për punime – janë pjesë të sistemit të sinjalistikës detare ku çdo element duhet të përmbushë standarde të sakta dimensionale, materiale dhe funksionale.

Kërkesa për paraqitjen e mostrave në datën dhe orën e hapjes së ofertave lejon autoritetin kontraktor të kryejë një kontroll praktik dhe të verifikojë përputhshmërinë reale të artikujve me specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Ky proces siguron që produktet e ofruara nuk janë thjesht deklarime në dokumentacion, por përputhen me kërkesat dimensionale, materiale dhe funksionale që garantojnë qëndrueshmëri dhe siguri në përdorim detar.

Ky kriter mban përgjegjësinë e operatorit ekonomik për ofrimin e produkteve origjinale dhe të testuara, duke reduktuar rreziqet për cilësinë dhe funksionimin e sistemit të sinjalistikës detare.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Specifikimet teknike:

Nr	Emërtimi	Specifikimet Teknike
1	Spirancë për lidhjen e bovave detare	Spiranca të jetë tip çadër e palosshme me katër ganxha me material hekuri special e galvanizuar me metodën e galvanizimit të thellë në të nxehtë. Spiranca të ketë dhe bokullën fiksuese kur spiranca është e mbullur. Pesha e spirancës: 8kg. Në skajet e krahut qëndror të ketë 2 vrima $\varnothing$ 16mm për vendosjen e gametës (për lidhjen e litarit ose zinxhirit të bovës) dhe vrima tjetër për të lidhur aksesore për nxjerrjen e spirancës në rastet kur spiranca ngec në terrene të vështira.
2	Bova lundruese sinjalizuese bikonike 27cm, e kuqe	Bova lundruese sinjalizuese në formë bikonike në ngjyrë te kuqe. Diametër: $\Phi$ 260-270mm Gjatësia e përgjithshme: 590-600mm Materiali: Polietilen i fryrë. Vëllimi:9lt Nga njëra anë të ketë 1 vrimë për kalimin e litarin dhe nga ana tjetër 2 vrima për lidhje të ndryshme.
3	Bova lundruese sinjalizuese bikonike 27cm, e verdhë	Bova lundruese sinjalizuese në formë bikonike në ngjyrë te verdhë. Diametër: $\Phi$ 260-270mm Gjatësia e përgjithshme: 590-600mm Materiali: Polietilen i fryrë. Vëllimi: 9lt Nga njëra anë të ketë 1 vrimë për kalimin e litarin dhe nga ana tjetër 2 vrima për lidhje të ndryshme.
4	Bova lundruese sinjalizuese cilindrike 13 cm, e kuqe	Bova lundruese sinjalizuese në formë cilindrike në ngjyrë të kuqe. Diametër: $\Phi$ 120-130mm Gjatësia e përgjithshme: 380-390mm Materiali: Polietilen i fryrë. Nga njëra anë të ketë 1 vrimë për kalimin e litarin dhe nga ana tjetër 1 vrimë për lidhje të ndryshme.
5	Bova lundruese sinjalizuese cilindrike 13cm e verdhë	Bova lundruese sinjalizuese në formë cilindrike në ngjyrë të verdhë. Diametër: $\Phi$ 120-130mm Gjatësia e përgjithshme:380-390mm

		Materiali: Polietilen i fryrë. Nga njëra anë të ketë 1 vrimë për kalimin e litarin dhe nga ana tjetër 1 vrimë për lidhje të ndryshme.
6	Litar lundruës plastik Ø 12mm (ngjyrë portokalli)	Litar markimi. Tipi: Lundruës. Material: Polipropilen. Ngjyra: Portokalli e dukshme. Thurja: Tre gërsheta. Paketimi: bobinë me 200 metra litar.

Specifikimet teknike të artikujve të sinjalistikës detare janë të dizajnuara për të garantuar funksionim të sigurt, qëndrueshmëri dhe performancë optimale në mjedise të vështira detare. Spiranca për lidhjen e bovave detare është një komponent kritik për stabilitetin e bovave, dhe kërkesat e saj teknike, si tipi çadër e palosshme, katër ganxhat, hekuri special i galvanizuar me metodën e galvanizimit të thellë në të nxehtë, pesha prej 8 kg dhe vrimat për lidhje të gametës dhe aksesorëve, sigurojnë që spiranca të mundësojë vendosje të sigurt, lehtësi në nxjerrje në rast ngecjeje dhe qëndrueshmëri afatgjatë ndaj korrozionit dhe ndikimeve të detit. Bokulla fiksuese e spirancës garanton mbajtjen e saj në pozicion kur është e mbushur dhe e gatshme për përdorim.

Bovat lundruese sinjalizuese bikonike 27 cm, të kuqe dhe të verdha, janë projektuar me diametër 260–270 mm dhe gjatësi 590–600 mm, me vëllim 9 litra dhe material polietilen i fryrë, që siguron lehtësi, rezistencë ndaj ndikimeve të valëve dhe ekspozimit në diell, dhe dukshmëri të lartë vizuale në ujë. Vrimat për kalimin e litarit dhe lidhje të tjera mundësojnë montim të sigurt në sistemin e ankorimit dhe përdorim fleksibël sipas kërkesave operative.

Bovat lundruese cilindrike 13 cm, të kuqe dhe të verdha, kanë diametër 120–130 mm dhe gjatësi 380–390 mm, me polietilen të fryrë, duke ofruar një kombinim optimal mes lehtësisë, qëndrueshmërisë dhe dukshmërisë. Dizajni i vrimave për kalimin e litarit dhe lidhje të ndryshme siguron lidhje të fortë dhe të besueshme me spirancën dhe elementë të tjerë të sistemit të sinjalistikës. Litarët lundruës plastik Ø 12 mm janë të prodhuar nga polipropileni, i thurur në tre gërsheta dhe me ngjyrë portokalli të dukshme, gjë që garanton dukshmëri maksimale dhe rezistencë ndaj ujit dhe konsumimit mekanik. Paketimi në bobina prej 200 metrash lehtëson menaxhimin, transportin dhe instalimin në terren.

Të gjitha këto specifikime teknike janë të hartuara për të siguruar që çdo komponent i sinjalistikës detare funksionon në mënyrë të integruar, duke përbushur standardet e sigurisë, dukshmërisë dhe qëndrueshmërisë që kërkohen për përdorim në mjedise detare, ku rreziqet nga dallgët, erërat dhe korrozioni janë të larta. Këto karakteristika garantojnë jo vetëm funksionalitetin e sistemit, por edhe sigurinë e lundrimit dhe qëndrueshmërinë e investimit.

Specifikimet teknike, për mallin objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika

38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

**Afatet e lëvrimit:** 7 (shtatë) ditë kalendarike nga lidhja e kontratës.

Afati i lëvrimit prej 7 ditësh kalendarik nga data e lidhjes së kontratës është i justifikuar në mënyrë teknike dhe operacionale duke pasur parasysh natyrën dhe karakteristikat e artikujve të sinjalistikës detare që do të furnizohen. Artikujt, si spirancat për lidhjen e bovave, bovat lundruese bikonike dhe cilindrike dhe litarët lundrues, janë produkte standarde dhe të prodhuara në linja të gatshme për furnizim, të cilat nuk kërkojnë kohë të gjatë prodhimi apo përpunimi të veçantë.

Ky afat i shkurtër lëvrimi mundëson furnizim të shpejtë dhe vazhdimësi në punimet detare, duke shmangur vonesa që mund të ndikojnë në vendosjen dhe funksionimin e sistemit të sinjalistikës, i cili është kritik për sigurinë e lundrimit dhe jo vetëm. Nga pikëpamja logjistike, artikujt mund të transportohen dhe dorëzohen lehtësisht brenda këtij afati, duke përfshirë kontrollin paraprak të cilësisë dhe verifikimin e mostërave përkatëse në terren.

Për më tepër, ky afat i përcaktuar siguron balancë midis nevojës për shpejtësi në furnizim dhe mundësisë së operatorit ekonomik për të organizuar transportin dhe dorëzimin në mënyrë të sigurt dhe të kontrolluar. Afati prej shtatë ditësh gjithashtu mundëson që kontraktori të respektojë procedurat administrative dhe teknike të pranimi të mallrave, duke garantuar që të gjitha pajisjet të jenë të verifikuara, të testuara dhe të përputhshme me specifikimet teknike të kontratës para përdorimit në fushë. Në këtë mënyrë, afati i lëvrimit është i përshtatshëm për mbarëvajtjen e projektit dhe për mbrojtjen e interesit publik, duke garantuar që sinjalistika detare të vendoset në kohë dhe të funksionojë sipas standardeve të kërkuara.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**